


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	20 /DPK
Nr. ftag Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Bi. Prot. Prot No.	01-407/14
Data Datum Date	31.01.2014
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 29.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-4298/13 për z. *Shafi Gashi – Drejtor i Muzeut të Kosovës (MKRS)*, për shkak se ështëshmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4298-13, për Zyrtarin e lartë, z. Shafi Gashi – Drejtori i Muzeut të Kosovës – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznese private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Shafi Gashi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit (AKK), pas të cilës ai është paraqitur në AKK, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Shafi Gashi, është deklaruar se do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuara për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Gashi, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjellë dy shkresa zyrtare nga Agjensioni për Regjisrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-306-14, dhe DPK-03-307-14) në të cilat shihet se te bizneset privat "Sh.N.J. Construction" Sh.p.k. dhe "Drini Company" Sh.p.k., duke ruajtur vetëm të drejten pasive të pronësisë, ai tashmë ka hequr dorë nga funksionet e tija si person i autorizuar, për të ushtruar kështu vetëm funksionin e tij publik si Drejtor i Muzeut të Kosovës në kuadër të MKRS-së.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorek i DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

